

VENDIM
Nr.279, datë 28.4.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE
SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen që i bashkëlidhet vendimit nr.313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, në pikën 9 të kreut XXXIV, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës të bëhet 250 (dyqind e pesëdhjetë) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 084 (një mijë e tetëdhjetë e katër) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano